



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 216/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, përkatësisht Ekrem Mustafë-s, ish Ministër i Punëve të Brendshme, për shkak të shfrytëzimit të autoritetit zyrtar, gjatë aktivitetit promovues zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr. 216/2019 e datës 04.10.2019, e paraqitur nga Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, kunder koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, sepse ish Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, tani kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, më datë 01.10.2019, rreth orës 11:00, përmes llogarisë së tij në facebook, ka postuar një video- fushatë promovuese për veten, dhe subjektin e tij politik, në të cilën video ka përdorë fotografi në të cilën shihet – paraqitet Rashit Qalaj Drejtori i Përgjithshëm, Policisë së Kosovës, që paraqet shkelje, nenit 35 par.2, të LZP-së, i SHQIPOHET gjobë në lartësi prej 9,500.00 (nëntëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 04.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.116/2019, nga Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilat pretendohet se ish Ministri i Punëve të Brendshme, tani kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, më datë 01.10.2019, rreth orës 11:00, përmes llogarisë së tij në facebook, ka postuar një video fushatë promovuese për veten dhe subjektin e tij politik, në të cilën video ka përdorë fotografi në të cilën shihet – paraqitet Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj, fotografi kjo e përdorur pa lejen e këtij të fundit, veprime këto të cilat sipas paraqitësit të ankesës bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së, respektivisht nenin 35 par.2, të këtij ligji, duke kërkuar nga PZAP-i, që kjo çështje të shqyrtohet më detajisht.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një CD, në cilësi të provës materiale.

Koalicioni NISMA-AKR-PD, në përgjigjen në ankesë të datës 05.10.2019, pranoi se nga ana e z.Ekrem Mustafa, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit në fjalë, në llogarinë e tij në facebook, është postuar videoja në fjalë, por që përkundër faktit se videoja është postuar në kohë fushate, asnjëherë nuk ka pasur qëllim shfrytëzimin e autoritetit zyrtar të ankuesit. Në fund ka shtuar se nga ana e koalicionit NISMA-AKR-PD, janë ndërmarrë masa përmirësuese, dhe në respekt të personalitetit të ankuesit, video e postuar, është hequr nga llogaria e facebook-ut, menjëherë pas pranimit të ankesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2, të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**, për këto arsye:

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës si CD-në, e ofruar si provë materiale, e cila është publikuar në llogarinë e facebook-ut, të kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, përgjigjes në ankesë të koalicionit në fjalë, dhe shkresave tjera të lëndës, ka vlerësuar se nga ana e koalicionit NISMA-AKR-PD, është shkelur dispozita e nenit 35 par.2 të LZP-së, e cila përcakton se: *“Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik”*, për faktin se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, Ekrem Mustafa, në një video të cilën ai e ka postuar në llogarinë e tij në facebook, është paraqitur një fotografi e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, pa lejen e tij, që do të thotë se me këtë veprim konsiderohet se nga ana e kandidatit në fjalë, gjatë aktivitetit promovues zgjedhor është përdorë pozita publike e këtij ankuesit, Rashit Qalaj, shkelje kjo e sanksionuar me dispozitën e lartëcekur ligjore.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjektet e koalicionit NISMA-AKR-PD, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti gjatë aktivitetit të tyre zgjedhor, nga ana e njërit prej kandidatëve të tyre për deputet, janë përdorur fotografitë në të cilat është Rashit Qalaj – Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, si dhe pjestarë të policisë, gjatë së cilës video në mënyrë të kuartë bëhet thirrje për të votuar, atë si kandidat për deputet, si dhe të koalicionit NISMA-AKR-PD, për zgjedhjet për Kuvendin e Reoublikës së Kosovës, që mbahen me datë 6 tetor 2019. Duke marrë parasysh faktin se në fotot e publikuara në video është i përfshirë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, foto të cilat siç shihet nga pamjet janë

bërë gjatë takimeve zyrtare, tregon se është përdorur pozita e tij publike, për të bërë fushatë, që përbën veprim të ndaluar, në kuptim të nenit 35 paragrafi 2. të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë, i'u dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirësojë shkeljen e bërë, mirëpo subjekti politik megjithëse e ka pranuar shkeljen e bërë, dhe ka theksuar se e njëjta është evituar nga ana e tyre, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me atë se është bërë përmirësimi i shkeljes siç kërkohet me nenin 120 paragrafi 1 pika a) e LPZ-së, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, si në dispozitiv të këtij vendimi, në kuptim të nenit 35 paragrafi 2, nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullës Nr. 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.216/2019 më datë 05.10.2019

Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.